

KONTRATË

E lidhur me date: 07.08.2019.

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"Fame" Sh.p.k-Prishtine (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi me uniforma për stafin e Q.K.M.F.-se në Dragash me numër Identifikues

621-19-4939-1-3-6, dhe nr. te brendshem 621-2019-061-136

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Dragashit
Opština Dragash
03 Nr. B. 400-15193
07-08 19
20
Dragash - Dragash

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizimi me uniforma për stafin e Q.K.M.F.-se në Dragash**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **07.08.2019, dhe përfundon me date 07.09.2019**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [kryerjes së furnizimeve] do të jetë **Q.K.M.F- Dragash**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

1.6. Menagjer i kontratës **Behar Brenolli**

1.6. Menagjer i projektit(furnizimit) **Agim Dauti**

1.7 verejtje: Operatori Ekonomik fitues është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës t'i merr masat e veshmbathjes së punetoreve të Q.K.M.f-se.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **5,140.00 €**; (*pese mij e njeqind e dyzet Euro*).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Ne fund kerkohet nje raport per pranim te mallit nga ana e menagjerit te kontrates dhe komisionit per pranim te mallit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[furnizimeve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit *[furnizimeve]*, sipas deklarates se ofruar nga kompanija juaj. Kjo duhet te behet ne fund para pageses se mallit te ofruar ne vleren prej 10% te vleres se kontrates ose 514 €, per nje vit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykatën themelore në Prizren, dega ne Dragash** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	“ Fame” Sh.p.k-Prishtine	Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	MENAGJER	Pozita:	Zyrtar pergjegjes i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.08.2019.	Data:	07.08.2019.
Vula:		Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

PARAMASA - Furnizimi me uniforma per stafin e Q.K.M.F-se ne Dragash

Nr.	Artikulli	Njesia	Sasia	Modeli	Cmimi €	total
1	Bluze "V" me minge te shkurta, me ambleme te qepur te QKMF-se dhe Pantallona per femra Materiali: 65%Poliester - 35%Viskoze Ngjyra e bardhe	32	Pale		18	576.00
2	Bluze dhe Pantallona per mashkuj me minge te gjata, me ambleme te qepur te QKMF-se Materiali: 65%Poliester - 35%Viskoze Ngjyra e bardhe	120	Pale		18	2160.00
3	Mantil per mashkuj , me ambleme te qepur te QKMF-se Materiali: 65%Poliester - 35%Viskoze Ngjyra e bardhe	44	Cope		8	352.00
4	Kilompe/Papuge Materiali: Pjesa e sipërme berbehet prej lekure, pjesa e poshtme eshte prej poliurethane ekologjik, nuk permban pvc. Ngjyre e bardhe	196	Pale		5	980.00
5	Jelek vere per urgjence, me shirita reflektues, me ambleme te qepur te QKMF-se Materiali: 65%Poliester - 35%Pambuk Ngjyre e kuqe	26	Cope		8	208.00
6	Khakete vere per urgjence, me shirita reflektues, me ambleme te qepur te QKMF-se Materiali: 65%Poliester - 35%Pambuk Ngjyre e kuqe	26	Cope		10	260.00
7	Pantallona vere per urgjence, me shirita reflektues Materiali: 65%Poliester - 35%Pambuk Ngjyre e kuqe	26	Pale		8	208.00
8	RROBA PUNE vere per femra Bluze me minge te gjata, me ambleme te qepur te QKMF-se, dhe pantallona vere Materiali: 65%Poliester - 35%Viskoze Ngjyra bordo	10	Pale		18	180.00
9	RROBA PUNE vere Xhakete me ambleme te qepur te QKMFse, dhe pantallona vere Materiali: 65%Poliester - 35%Pambuk Ngjyra kalter e mbyllte	12	Pale		18	216.00
Total						5140.00

Verejtje: Operatori ekonomik fitues është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës ti merr masat veshëmbathjes se punëtorëve të QKMF-së